

BASHKIA VLORË

BUXHETI I VITIT 2025

Pasqyra e Lendes

| | |
|--|---------|
| Projekt vendim për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2025 | 3-10 |
| Kapitulli I: Informacion i përgjithshëm mbi buxhetin e bashkisë Vlorë për vitin 2025 | 11-18 |
| Kapitulli II: Parashikimi i të ardhurave në buxhetin e bashkisë Vlorë për vitin 2025 | 19 |
| II.1. Tabelë përmbledhëse e të ardhurave | 21 |
| II.2. Të ardhurat nga taksat vendore | 24 |
| II.3. Të ardhurat nga tarifatat vendore | 31 |
| II.4. Të ardhura të tjera | 56 |
| II.5. Të ardhura nga buxheti i shtetit (transferta e pakushtëzuar) dhe specifike | 63 |
| Kapitulli III: Parashikimi shpenzimeve në buxhetin e bashkisë Vlore për vitin 2025 | 64 |
| III.1. Përmbledhëse e Shpenzimeve | 64 |
| III.2. Shpenzime të detajuara në nivel projekti | 66 |
| III.2.1. Shpenzime për administratën e bashkisë | 66 |
| III.2.2. Shpenzime për përforcuesin | 78 |
| III.2.3. Shpenzime për funeral dekorin | 78 |
| III.2.4. Pastrimit urban në qytetin e Vlorës | 79 |
| III.2.5. Shpenzime Ndërmarrje Menaxhim Mbetje | 83 |
| III.2.6. Shpenzime për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike | 88 |
| III.2.7. Shpenzime për Ndërmarrjen e Pastrimit | 93 |
| III.2.8. Shpenzime për Ndërmarrjen e Gjellbërimit | 96 |
| III.2.9. Shpenzime për mirëmbajtjen e varrezave | 98 |
| III.2.10. Shërbime për ndriçimin rrugor | 102 |
| III.2.11. Shërbime për transportin urban | 106 |
| III.2.12. Shërbime për Merkatën e peshkut | 107 |
| III.2.13. Shpenzime për shumësportin | 110 |
| III.2.14. Shpenzime për Qendrën Kulturore | 134 |
| III.2.15. Shpenzime për Teatrin “Petro Marko” | 136 |
| III.2.16. Shpenzime për arsimin 9 vjeçar | 138 |
| III.2.17. Sh. A Trajtimi Studentor | 142 |
| III.2.18. Shpenzime për PAK | 144 |
| III.2.19. Shpenzime për çerdhet dhe Qendra Komunitare | 146 |
| III.2.20. Shpenzime për shtëpinë e fëmijës | 152 |
| III.3. Transferata specifike | 153 |
| III.3.1. Shpenzime PMNZSH | 154 |
| III.3.2. Shpenzime për ujitjen dhe kullimin | 156 |
| III.3.3. Shpenzime për administratën e pyjeve | 159 |
| III.3.4. Shpenzime për rrugët rurale | 161 |
| III.3.5. Shpenzime për arsimin parauniversitar | 163 |
| III.3.6. Për arsimin e mesëm | 165 |
| III.3.7. Shpenzime për konviktet | 166 |
| III.4. Investime | 168-172 |



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË
VENDIM NR 111 DATE 27.12.2024

PËR

MIRATIMIN E BUXHETIT TE BASHKISE PER VITIN 2025

Këshilli i Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e tij të datës .12,2024 pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga grupi i punës për hartimin e buxhetit të Bashkisë Vlorë për vitin 2025 si dhe propozimet e këshilltarëve, mbështetur në:

- Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, 9 pika 1.1.b, 34, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c;
- Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit e buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar
- Ligjit 115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrative Territoriale të Njërive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,
- Ligji nr. 45/2019 “Per mbrojtjen civile”, neni 65.
- Udhëzimi i MFE nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”
- Udhëzim i Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë nr.3, date 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2025-2027”
- Udhëzim i Ministrisë se Financave dhe Ekonomisë (Plotesues)nr.8, date 05.07.2024 “Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2025-2027”
- V.K.B Nr. 92, datë 23.11.2023 “Për miratimin e numrit te punonjësve dhe nivelit të pagave te bashkisë, institucioneve te varësisë dhe funksionet e deleguara -2024”.
- V.K.B Nr. 96, datë 07.12.2023 “Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024”, shprehur i ligjshëm nga prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 1038/1 prot., datë 12.12.2023.

V E N D O S I:

| | |
|---|------------------|
| 1. Të miratojë të ardhurat si më poshtë (në 000 lekë): | 3,769,094 |
| • Te ardhura gjithsej | |
| a. Të ardhurat e veta | 2,308,523 |
| i. Të ardhura nga taksat vendore | 1,162,337 |
| ii. Të ardhurat nga tarifatat vendore | 679,087 |

| | |
|---|------------------|
| iii. Të ardhura të tjera | 467,099 |
| b. Të ardhura nga granti i pakushtëzuar | 877,759 |
| c. Të ardhura nga transferta speciale | 582,812 |
| | |
| 2. Të miratohet shpenzimet si më poshtë (ne 000 lekë): | |
| Shpenzime gjithsej: | 3,769,094 |
| | |
| I. Shpenzime nga granti | 877,759 |
| nga këto: | |
| a. Për pagat (art.600) | 542,803 |
| b. Për sigurimet shoqërore (art.601) | 93,535 |
| c. Për shpenzime operative (art.602) | 241,421 |
| d. Fondi i mbrojtjes civile+fondi rezerv (609) | 0 |
| e. Transferten (art.166 dhe 651) | 0 |
| | |
| II. Shpenzime nga të ardhurat | 2,308,523 |
| nga këto: | |
| a. Për pagat (art.600) | 548,735 |
| b. Për sigurimet shoqërore (art.601) | 84,409 |
| c. Për shpenzime operative (art.602) | 650,894 |
| d. Për transferta (art.166-651-604-606) | 37,586 |
| e. Për subvencion (art.603 Q. Studentore, shërbimi urban) | 59,388 |
| f. Fondi i mbrojtjes civile+fondi rezerv (art.609) | 95,588 |
| g. Për investime (art.231) | 831,923 |
| | |
| III. Shpenzime nga transferta specifike | 582,812 |
| a. Për pagat (art.600) | 460,358 |
| b. Për sigurimet shoqërore (art.601) | 73,331 |
| c. Për shpenzime operative (art.602) | 49,123 |

3. Të ardhurat e Bashkisë Vlorë për vitin 2025.

| Nr. | EMERTIMI | Fakti 2022 | Fakti 2023 | Plani 2024 | I pritsh 2024 | Plani 2025 |
|------------|---|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| I | Të ardhura nga taksat vendore | 766,957 | | 997,619 | | 1,162,337 |
| 1.1 | Te ardhura nga Agjentet Tatimor | 123,600 | 83,826 | 113,500 | 114,190 | 126,500 |
| 1 | Taksë për kalimin e së drejtës së pronësisë | 30,000 | 25,805 | 23,000 | 35,700 | 30,000 |
| 2 | Taksë e automjeteve të përdorura | 75,600 | 56,638 | 87,800 | 75,000 | 92,500 |
| 3 | Taksa e biznesit të vogël (Tatim i Thjeshtuar) | 18,000 | 1,383 | 2,700 | 3,490 | 4,000 |
| 1.2 | Taksë e pasurisë së paluajtshme (ndërtesat+toka bujq.) | 643,357 | 506,906 | 884,119 | 549,226 | 1,035,837 |
| 1 | Taksë pasurie e paluajtshme ndërtesa | 250,732 | 145,075 | 236,954 | 185,367 | 238,588 |
| 2 | Taksë pasurie e paluajtshme tokë bujqësore | 38,758 | 11,718 | 38,739 | 13,738 | 40,337 |
| 3 | Taksë trualli | 12,371 | 13,317 | 14,625 | 12,344 | 15,623 |
| 4 | Taksë e fjetjes në hotel | 18,743 | 22,692 | 27,224 | 46,145 | 47,220 |
| 5 | Taksë e ndikimit në infrastrukturë | 298,853 | 244,581 | 502,802 | 223,472 | 613,000 |
| 6 | Taksë table + reklame | 11,000 | 19,022 | 21,024 | 23,071 | 27,453 |
| 7 | Taksë parkimi | 1,900 | 3,829 | 5,177 | 6,085 | 6,706 |
| 8 | Taksa mbi të ardhurat Personale | 11,000 | 46,672 | 37,574 | 39,004 | 46,910 |
| 11 | Të ardhurat nga tarifatat vendore | 351,620 | 282,911 | 495,389 | 572,390 | 619,087 |
| 1 | Tarifë për zenien e hapësirave publike | 319,920 | 105,454 | 150,250 | 149,070 | 135,261 |
| 1.1 | Tarifë tregu | 5,640 | | 1,583 | | 1,583 |
| 1.2 | Tarifë e zenies se hapësirave publike | 78,996 | 61,695 | 78,029 | 89,585 | 103,678 |
| 1.3 | Tarifë e zenies se hapësirave publike plazh | 235,284 | 43,759 | 70,638 | 59,485 | 30,000 |
| 2 | Tarifë vjetore për pastrimin urban+ndriçim+gjëlberim | 14,164 | 168,562 | 298,035 | 312,100 | 350,704 |
| 3 | Tarifë shërbimi për subjektet me aktivitet ndërtimi | 0 | 110 | 26,915 | 24,646 | 27,000 |
| 5 | Tarifë për shërbime të tjera nga pushteti vendor | 5,033 | 149 | 5,033 | 75,682 | 80,294 |
| 6 | Tarifë për leje dhe çertifikata transporti | 8,520 | 4,916 | 11,173 | 7,939 | 21,328 |
| 7 | Tarifa e Ujitjes | 3,983 | 3,720 | 3,983 | 2,953 | 4,500 |
| 111 | Të ardhura të tjera | 210,451 | 100,457 | 322,544 | 205,691 | 423,035 |
| 1 | Të ardhura nga qirate (mjete+godine+toke) | 41,325 | 8,670 | 41,325 | 32,051 | 39,727 |
| 2 | Të ardhura nga aplikimi i gjobave dhe debitorë | 148,300 | 77,875 | 258,946 | 156,911 | 358,283 |
| 3 | Të ardhura nga kopshtet, çerdhet dhe shkollat | 20,826 | 13,912 | 22,273 | 16,729 | 25,025 |
| 4 | Të ardhura nga institucionet vartëse | 70,920 | 4,636 | 77,720 | 17,020 | 104,064 |
| 4.1 | Të ardhura nga teatri "Petro Marko" | 550 | 1,005 | 790 | 875 | 964 |
| 4.2 | Të ardhura nga Qendra Kulturore | 1,550 | 1,200 | 1,875 | 1,004 | 1,950 |
| 4.3 | Të ardhura nga Shumesportet | 595 | 150 | 755 | 810 | 850 |
| 4.4 | Të ardhura nga ndërmarrja Shërbimeve Publike | 300 | 38 | 1,000 | 10,881 | 10,000 |
| 4.5 | Të ardhura nga pullat | 700 | 300 | 300 | 250 | 300 |
| | Projekte | 67,225 | 1,943 | 73,000 | 3,200 | 90,000 |
| 5 | Të ardhura të trashëguara | | | | | |
| 1V | TOTALI I TË ARDHURAVE (Taksa Tarifa) | 1,399,948 | 978,736 | 1,893,272 | 1,458,517 | 2,308,523 |
| 1 | Transferta e pakushtëzuar | 565,117 | 674,396 | 798,527 | 798,527 | 877,759 |
| 2 | Transferta e pakushtëzuar e trashëguar | | | | | 0 |
| V | Total Transferta e pakushtëzuar | 565,117 | 674,396 | 798,527 | 798,527 | 877,759 |
| VI | Transferta e Pakushtëzuar + të Ardhurat e Veta | 1,965,065 | 1,653,132 | 2,691,799 | 2,257,044 | 3,186,282 |
| 1 | Transferta e pakushtëzuar sektoriale | 429,407 | 447,453 | 485,785 | 485,785 | 582,812 |
| 2 | Transferta e pakushtëzuar sektoriale e trashëguar | | | | | |
| VII | Total transferta e pakushtëzuar sektoriale | 429,407 | 447,453 | 485,785 | 485,785 | 582,812 |
| | BUXHETI I PËRGJITHSHËM | 2,394,472 | 2,100,585 | 3,177,584 | 2,742,829 | 3,769,094 |

4. Shpenzimet nga granti i pakushtezuar dhe nga te ardhurat e veta do të përdoren sipas tabelës .

| Emertimi | SHPENZIMET E PLANIFIKUARA PER VITIN | | | | | | | | | | | | | | | | | | | GRANT+TE ARDHURA |
|--|-------------------------------------|--------|---------|-----|-----|-----|-----|---------|-------------|--------|---------|--------|--------|-------|--------|-------|--------|---------|-----------|------------------|
| | GRANTI | | | | | | | | TE ARDHURAT | | | | | | | | | | | |
| | 600 | 601 | 602 | 609 | 651 | 166 | 231 | TOTALI | 600 | 601 | 602 | 603 | 604 | 606 | 609 | 651 | 166 | 231 | TOTALI | |
| Administrata e Bashkise | 230,000 | 39,000 | 120,000 | | | | | 389,000 | 193,496 | 30,837 | 185,743 | | 21,468 | 2,500 | | | | 123,360 | 557,404 | 946,404 |
| Repetitoret | | | 96 | | | | | 96 | 0 | 0 | 0 | | | | 0 | 0 | 0 | | 0 | 96 |
| Mb.Dekori | | | 5,000 | | | | | 5,000 | 0 | 0 | 0 | | | | 0 | 0 | 0 | | 0 | 5,000 |
| Mb.Varreza (NSHP) | 10,000 | 2,000 | | | | | | 12,000 | 16,275 | 2,192 | 21,826 | | | | 0 | 0 | 0 | 720 | 41,013 | 53,013 |
| PMNZH | | | | | | | | 0 | 16,028 | 2,176 | 5,600 | | | | 0 | 0 | 0 | | 23,804 | 23,804 |
| Administrimi I pyjeve dhe kullotave | | | | | | | | 0 | 8,491 | 1,301 | 400 | | | | 0 | 0 | 0 | | 10,192 | 10,192 |
| Rrjeti Rrugor | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | 0 | 0 | 0 | 362,479 | 362,479 | 362,479 |
| Rruget Rurale | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 |
| Pastrimi Bashkia | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 71,255 | | | | 0 | 0 | 0 | | 71,255 | 71,255 |
| NMM | 7,000 | 1,500 | | | | | | 8,500 | 34,519 | 4,582 | 74,665 | | | | 0 | 1,056 | 12,562 | 450 | 127,834 | 136,334 |
| Nd Gjelberimi | 50,000 | 8,400 | 15,000 | | | | | 73,400 | 52,926 | 8,479 | 250 | | | | 0 | 0 | 0 | 3,150 | 64,805 | 138,205 |
| Ujesjellesi | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 |
| ND.Sherb.Publike | 45,000 | 7,600 | 15,000 | | | | | 67,600 | 64,441 | 10,470 | 52,515 | | | | 0 | 0 | 0 | 80 | 127,506 | 195,106 |
| ND Pastrimit | 120,000 | 20,000 | 15,000 | | | | | 155,000 | 45,091 | 7,730 | 49,120 | | | | 0 | 0 | 0 | 1,800 | 103,741 | 258,741 |
| Sherbimi urban shtresa ne nevoje | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 15,360 | | | 0 | 0 | 0 | | 15,360 | 15,360 |
| Merkata e peshkut | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 22,028 | | | 0 | 0 | 0 | | 22,028 | 22,028 |
| Zhvillimi I komunitetit | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 |
| Nd.Ndricimit rrugor | 10,000 | 1,700 | 31,325 | | | | | 43,025 | 3,062 | 377 | 60,575 | | | | 0 | 0 | 0 | 21,000 | 85,014 | 128,039 |
| Kl.Shumesportesh | 10,000 | 1,700 | 15,000 | | | | | 26,700 | 8,329 | 1,215 | 32,830 | | | | 0 | 0 | 0 | 3,000 | 45,374 | 72,074 |
| Futbolli | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 |
| Qendra Kulturore | 14,000 | 2,500 | 3,000 | | | | | 19,500 | 20,869 | 3,046 | 14,460 | | | | 0 | 0 | 0 | 4,300 | 42,675 | 62,175 |
| Teatri Petro Marko | 16,000 | 3,000 | 3,000 | | | | | 22,000 | 14,870 | 1,910 | 8,810 | | | | 0 | 0 | 0 | 6,000 | 31,590 | 53,590 |
| Qendra Studentore | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | 22,000 | | | 0 | 0 | 0 | | 22,000 | 22,000 |
| Arsimi | 10,000 | 2,000 | 16,000 | | | | | 28,000 | 26,457 | 3,798 | 56,540 | | | | 0 | 0 | 0 | 301,084 | 387,879 | 415,879 |
| Qendra PAK | 5,000 | 1,000 | 1,000 | | | | | 7,000 | 13,000 | 2,006 | 4,000 | | | | 0 | 0 | 0 | 4,500 | 23,506 | 30,506 |
| Cerdhet +Qender Mbeshtetese dhe Multifun | 15,803 | 3,135 | 2,000 | | | | | 20,938 | 30,881 | 4,290 | 10,385 | | | | 0 | 0 | 0 | | 45,556 | 66,494 |
| Shtepia Efemijes | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 1,920 | | | | 0 | 0 | 0 | | 1,920 | 1,920 |
| Fondi I mbrojtjes civile +fondi I emergjencave | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | 95,588 | 0 | 0 | | 95,588 | 95,588 |
| Projektet me fonde te huaja | | | | | | | | 0 | 0 | 0 | 0 | | | | 0 | 0 | 0 | | 0 | 0 |
| SHUMA | 542,803 | 93,535 | 241,421 | 0 | 0 | 0 | 0 | 877,759 | 548,735 | 84,409 | 650,894 | 59,388 | 21,468 | 2,500 | 95,588 | 1,056 | 12,562 | 831,923 | 2,308,523 | 3,186,282 |

5. Shpenzimet e grantit specifik do te përdoren si me poshtë:

| Kap | Program i | Emërtimi | SHPENZIMET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2025 | | | |
|-----|-----------|--|--|--------|--------|---------|
| | | | 600 | 601 | 602 | Totali |
| 4 | K03280 | PMNZSH | 46,926 | 7,837 | 9,000 | 63,763 |
| 7 | K04240 | Ujitja dhe Kullimi | 16,411 | 2,624 | 27,644 | 46,679 |
| 7 | K04260 | Administrimi pyjor | 6,257 | 1,045 | | 7,302 |
| 8 | K04520 | Rrugët rurale | 2,977 | 472 | | 3,449 |
| 21 | K09120 | Arsimi Para Universitar (kopshte, Qkf) | 339,215 | 53,444 | | 392,659 |
| 22 | K09232 | Arsimi i mesëm punonjës mbështetës | 34,787 | 5,716 | | 40,503 |
| 22 | K09240 | Konviktet e shkollave profesionale | 13,785 | 2,193 | 12,479 | 28,457 |
| | | SHUMA I | 460,358 | 73,331 | 49,123 | 582,812 |

6. Shpenzimet për investime sipas do të përdoren për objektet e mëposhtme:

| | Investimet e parashikuara per Buxhet 2025 | Vlera |
|----|---|--------------------|
| 1 | Rikonstruksioni I Kopshtit 1 Maj | 265,863,617 |
| 2 | Rikonstruksioni I bllokut te banimit prane Sig. Shoqerore | 58,700,000 |
| 3 | Rikonstruksion I trotuareve pergjate rruges Transballkanike | 152,279,383 |
| 4 | Rikonstruksioni I shkalleve ne Kuzum Baba | 28,000,000 |
| 5 | Rikonstruksion rruga Zenel Gjoleka (te ujesjellsi) | 55,000,000 |
| 6 | Rikonstruksion rrugët Panaja me ndricim + kendi sportiv | 25,000,000 |
| 7 | Rikonstruksion rrugët e brendshme Sherishte | 16,300,000 |
| 8 | Rikonstruksion rruga e varrezave ne Risili | 13,500,000 |
| 9 | Rikonstruksion rruga Jul Qezari ne Orikum | 13,700,000 |
| 10 | Kendi sportiv ne Orikum | 5,000,000 |
| 11 | Mobilim I shkolles Lef Sallata | 21,220,000 |
| 12 | Mobilim shkolla Avni Rustemi | 9,000,000 |
| 13 | Rikonstruksioni I hapësira rekreative | 25,000,000 |
| 14 | Shpronësime | 20,000,000 |
| 15 | Supervizime | 10,000,000 |
| 16 | Rikonstruksioni I banesat sociale | 20,000,000 |
| 17 | Paisje dhe inventare ekonomike | 4,246,000 |
| 18 | Ndertim Lere betoni Qafa e Qishes Radhime | 704,000 |
| 19 | Ndertim lere Betoni Ali Maci Tragjas | 450,000 |
| | Total | 743,963,000 |

Investime per institucionet vartese te manaxhura nga Bashkia

| Nr | Investime | Njesia | Sasia | Vlera ne leke |
|----|------------------------------|--------|-------|---------------|
| | NSHP | | | |
| 1 | Kamion 20 ton 4 akse km zero | | | 11,000,000 |
| | Nd.Pastrimi | | | |
| 2 | Kontenier 1.1 m3 | | | 4,160,000 |
| 3 | Kamioncine doppio kabin | copë | 1 | 2,400,000 |

| | | | | |
|----|---|------|---|-------------------|
| 4 | Automjet lavazho | copë | 1 | 2,400,000 |
| 5 | Autoveture | copë | 1 | 1,500,000 |
| | Nd.Gjelberimi | | | |
| 6 | Blerje stolash | copë | | 1,000,000 |
| 7 | Skrep | | 1 | 6,000,000 |
| 8 | Automjet tip pick-up | | 1 | 2,500,000 |
| 9 | Autobot për vaditje | copë | 1 | 9,000,000 |
| 10 | Kamioncinë vetshkarkuese me dopiokabinë | | 1 | 3,000,000 |
| | | | | 42,960,000 |

| Nr | Investime ne Institucione Vartëse dhe struktura te tjera. | Vlera ne leke |
|----|---|-------------------|
| 1 | Nderrmarja e Sherbimeve Publike | 80.000 |
| 2 | Klubi Shumesportesh Flamurtari | 3.000.000 |
| 3 | Qendra Kulturore | 4.300.000 |
| 4 | Qendra PAK | 4.500.000 |
| 5 | Nderrmarja e Pastrimi | 1.800.000 |
| 6 | Nd. E Gjelberimi | 3.150.000 |
| 7 | N.M. | 450.000 |
| 8 | Teatri Petro Marko | 6.000.000 |
| 9 | M.b varreza | 720.000 |
| 10 | Ndricimi rrugor | 21,000.000 |
| | TOTALI | 45.000.000 |

6. Kuotizacioni per Keshillin e Qarkut Vlore do te jete 1% e te ardhurave te arkëtuara ne llogari te Bashkise Vlore (Ne kete përqindje nuk do te përfshihen te ardhurat qe i vine Bashkisë Vlore nga agjentet tatimor dhe te ardhurat e përcaktuara me destinacion, si sponsorizime, kuotizacione qe paguajnë prindërit, debitorët e ndryshëm dhe gjoba).
7. Fondi për mbrojtjen civile + fondin rezervë dhe kontigjences për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, mbrojtjen civile si dhe për kryerjen e detyrave ne zbatim te ligjit nr. 65/2019 “Për mbrojtjen civile” eshte ne vlerën 95,588 mije leke.
8. Për fondin e planifikuar për emergjencën civile autorizohet Kryetari i Bashkisë dhe Komisioni Vendor për Emergjencat Civile ta përdorë atë në funksion të realizimit të detyrave për mbrojtjen e popullsisë civile në rastet e fatkeqësive në përputhje me Ligjin Nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile” dhe VKM Nr.414, datë 08.07.2021 “Për miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të Buxhetit të Shtetit për Mbrojtjen Civile”, si dhe ligjin për emergjencat civile.
9. Kryetari i Bashkisë autorizohet të përdorë fondin prej **8.480 mijë** lekë për vlerësimin financiar të nxënësve cilësorë të shkollave 9-vjeçare dhe të mesme të përgjithshme publike të qytetit në bashkëpunim me çdo drejtori shkolle (e mesme dhe 9-vjeçare) nga dy-tre nxënës për çdo shkollë (për nxënësit e shkollave 9-vjeçare 3 mijë lekë, kurse për nxënësit e shkollave të mesme 5 mijë lekë për periudhën janar-qershor).

10. Kryetari i Bashkisë autorizohet të bëjë transferimin e fondeve për artikujt e miratuar nga Këshilli Bashkiak brenda programit si dhe transferimin e fondit për projektet kulturore dhe sportive të miratuara në shumën 84,010 mijë lekë, sipas nevojave të institucioneve të varësisë.
11. Drejtorja e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit pranë Bashkisë, autorizohet të bëjë ndarjen e fondeve të miratuara nga Këshilli i Bashkisë sipas strukturës buxhetore të miratuar nga Ministria e Financës për çdo muaj.
12. Si prioritete të investimeve që mund të mbulohen nga burime të tjera financimi nga ministritë e linjes, F.ZH.R apo burime të tjera financimi edhe për vitin 2025 mbeten ato investime të parashikuara si prioritete gjatë vitit 2024 duke shtuar dhe objekte të reja për vitin 2025 si me poshte:

| Nr | Prioritetet e Investimeve 2025-2026 | vlera (000 lek) |
|----|---|-----------------|
| 1 | Rikonstruksion shkolla Ismail Qemali | 70,000 |
| 2 | Mobilimi I shkolles Ismail Qemali | 9,000 |
| 3 | Rikonstruksion shkolla Marigo Posjo | 115,000 |
| 4 | Mobilimi I shkolles Marigo Posjo | 21,220 |
| 5 | Rikonstruksion shkolla 4 Heronjte | 86,000 |
| 6 | Mobilimi I shkolles 4 Heronjte | 7,000 |
| 7 | Rikonstruksion I rruges Mevlan Halim Dervishi dhe pastrimi I kanalit te Siavit | 113,860 |
| 8 | Rikonstruksion I rruges Eduart Lir (tek ish fabr Cimentos) faza 2 | 118,000 |
| 9 | Rikonstruksion I rruges ne kodren Kuzum Baba | 46,700 |
| 10 | Rikonstruksion I rruges Sali Dibra (mbi shkollen tregtare) | 31,200 |
| 11 | Rikonstruksion I rruges Azem Sulo, Xhelal Veizi, Uji I Ftohte | 29,300 |
| 12 | Rikonstruksion I rruges Minella Anastasiadhi | 18,000 |
| 13 | Rikonstruksion I rruges Sazani, trotuar dhe korsi bicikletash | 132,000 |
| 14 | Rikonstruksion I rruges ne fshatin Trevllazer | 18,000 |
| 15 | Rikonstruksion I tregut se gjese se gjalle Novosele | 45,800 |
| 16 | Rikonstruksion I rrugeve te brendshme ne Babice te vogel | 23,300 |
| 17 | Rikonstruksion I rruges se Kallafetit , Sherishte | 15,400 |
| 18 | Rikonstruksion I rrugeve te brendshme ne Xhuherine | 33,700 |
| 19 | Rikonstruksion I rruges ne Xhuherine, lidhja me rrugen nacionale | 34,000 |
| 20 | Rikonstruksion I rruges Abaz Gjermeni ne Orikum | 17,800 |
| 21 | Rikonstruksion I rruges Dervish Hekali | 8,500 |
| 22 | Asfaltime rruget e qytetit dhe njesive | 70,000 |
| 23 | Mur rrethues ne rruget e lagjes Kushtrimi (invest I parashik ne akset rrugore) | 11,500 |
| 24 | Hapesire parkimi ne zonen e Lungomares, 2 kate nen toke dhe 3 kate mbi toke | 255,000 |
| 25 | Rikonstruksion I godines se Gjendjes Civile | 122,932 |
| 26 | Rikonstruksion I godines QKF (objekt 2 kate + 1 kat nen toke) | 310,807 |
| 27 | Rikonstruksion I godines Qendra Aulona dhe Cerdhes nr.15 | 41,385 |
| 28 | Rikonstruksion I bllokut te banimit prane shkolles Lef Sallata | 250,000 |
| 29 | Rikonstruksion I godines se Rajonit nr 4 | 8,000 |

| | | |
|----|--|------------------|
| 30 | Sistemi ujites ne rrugen transballkanike | 15,000 |
| 31 | Rkonstruksion lulishte ekzistuese dhe krijimi I hapësirave te reja | 40,000 |
| | SHUMA | 2,118,404 |

13. Vendimet e Gjykatave te paguhen për vitin 2025 ne shumen 10.945 mije leke.

14. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit Nr.139/2015, datë 17.12.2015, neni 55, pika 6.

KRYETARE

Elpiniqi Merkuri

KAPITULLI I: INFORMACION I PËRGJITHSHËM MBI BUXHETIN E BASHKISË VLORE PËR VITIN 2025

I. Legjislacioni mbi të cilin është mbështetur hartimi i Buxhetit 2025.

Buxheti është tërësia e te ardhurave, financimeve dhe shpenzimeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore të planifikuara, miratuar nga Këshilli i Bashkisë. Buxheti vendor përfshin të gjitha të ardhurat, shpenzimet dhe financimet e bashkisë. Me tej buxheti vendor përfshin një fond rezerve dhe një fond kontigjence, e mbi bazën e këtyre parimeve, ky buxhet është hartuar në zbatim të legjislacionit të mëposhtëm:

- Ligji nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 8 pika 2, 9 pika 1.1.b, 34, 35, 36, 37, 39, 40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c;
- Ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit të buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar
- Ligjit 115/2014 datë 31.07.2014 “Për ndarjen Administrative Territoriale të Njësisë të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,
- Ligji nr. 45/2019 “Per mbrojtjen civile”, neni 65.
- Udhëzimi i MFE nr.9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit”
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.3, date 28.02.2024 “Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2025-2027”
- Udhëzim i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (Plotesues)nr.8, date 05.07.2024 “Për përgatitjen e programit Buxhetor Afatmesëm vendor 2025-2027”
- V.K.B Nr. 92, datë 23.11.2023 “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksionet e deleguara -2024”.
- V.K.B Nr. 96, datë 07.12.2023 “Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024”, shprehur i ligjshëm nga prefekti i Qarkut Vlorë, me shkresën nr. 1038/1 prot., datë 12.12.2023.
- Ligje dhe akte të tjera ligjore.

PRIORITETET E QYTETARËVE TË BASHKISË VLORE PËR BUXHETIN 2024

Ky dokument financiar është mbështetur mbi parimin e transparencës së përdorimit të fondeve publike pasi ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e ofrimit të

shërbimeve, ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e qytetarëve në vendimmarrje, dhe rritjen e përgjegjshmërisë së të zgjedhurve ndaj qytetarëve. Në zbatim të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 16 pika 1 “*Organet e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes*” të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2016 për “*Vetëqeverisjen Vendore*” si dhe të ligjit Nr. 68, date 27.04.2017 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, Neni 5, pika ç “*Programet buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore vendore konsultohen me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore.*”, sipas një kalendari të hollësishëm, administrata e Bashkisë Vlorë ka realizuar një sërë konsultimesh me komunitetin dhe grupe të ndryshme interesi. Janë pikërisht këto takime që kanë qenë një burim i rëndësishëm informacioni mbi të cilin janë përcaktuar edhe prioritetet e bashkisë për vitin 2025.

Me qëllim pasjen e një panorame të përgjithshëm mbi prioritetet e përcaktuara nga qytetarët gjatë dëgjësive publike në vijim janë paraqitur si në formë statistikore edhe narrative informacioni dhe çështjet e trajtuara, duke u mbështetur në proces verbalit e mbajtura prej personave përgjegjës. Në vijim paraqiten të dhënat demografike mbi pjesëmarrësit, të dhënat statistikore të çështjeve të ngritura sipas kategorive dhe nënkategorive të buxhetit, për të përmbyllur me sugjerimet specifike dhe të hollësishme të ngritura nga qytetarët në çdo dëgjësë publike.

1. Të dhëna demografike të qytetarëve pjesëmarrës

Në një shtrirje kohore prej rreth 2 javëve u realizuan 9 konsultime publike, në 4 Njësitë administrative të Bashkisë Vlorë si dhe në 5 rajonet e qytetit, ku morrën pjesë **830** qytetarë,

Përsa i përket shpërndarjes demografike të pjesëmarrësve sipas vendbanimit, referuar edhe numrit të banorëve, pjesa më e madhe e tyre i përkisnin Bashkisë Vlorë, për të vijuar më tej me Njësinë Administrative Novoselë, Njësinë Administrative Orikum, Njësia Administrative Shushicë Njësinë dhe në fund Administrative Qendër, përkatësisht:

2. Kategoritë dhe nënkategoritë e buxhetit

Problematikat dhe çështjet e propozuara prej qytetarëve gjatë konsultimeve publike mbi projekt buxhetin e vitit 2025 në vijim janë të grupuara sipas kategorive të buxhetit ku në rend kronologjik janë renditur prej kategorisë që zë peshën më të madhe në përqindje tek problematika që zë peshën më të vogël. Infrastruktura dhe Shërbimet Publike vlerësuar nga 30% e qytetarëve, ndjekur nga Zhvillimi Ekonomik Vendor me 15% , Shërbimet Sociale vlerësohen nga 15 % e qytetarëve ndërsa investimet në Arsim vlerësohen nga 15% e individëve, Bujqësia, Zhvillimi Rural, Pyjet dhe Kullotat vlerësohen si zëra të rëndësishëm në buxhetin

bashkiak nga 10% e qytetarëve, Mbrojtja e Mjedisit vlerësuar nga 5% e qytetarëve, për të përfunduar me kategorinë Kultura, Sporti dhe Shërbimet Argëtuese me 10% të qytetarëve.

Nga analiza e prioriteteve dhe nevojave të qytetarëve të shprehura përmes komenteve në degjesat publike prioritete kryesore zgjedhur nga banorët, rezulton një shpërndarje në zërat e buxhetit si në tabelë:

| Zërat e buxhetit | Përqindja |
|--------------------------------------|-----------|
| Investime në infrastrukturën rrugore | 20% |
| Ujësjiellës kanalizime | 15% |
| Shërbimi i pastrimit | 10% |
| Ndriçimi publik | 10% |
| Zhvillimi ekonomik | 7% |
| Sipërfaqe të gjelbërta | 6% |
| Shërbimi i transportit | 5% |
| Mirembajtja e godinave të shkollave | 15% |
| Ujitja dhe kullimi | 7% |
| Turizmi, Sportet dhe Kultura | 5% |

3 . Sugjerimet specifike të qytetarëve të Vlorës;

Sugjerimet specifike të qytetarëve të Vlorës që kanë marrë pjesë në votimin online.

Në vijim janë paraqitur në mënyrë të detajuar propozimet e paraqitura për sejcilin rajon dhe njësi administrative, vlen të theksohet se janë përmendur vetëm kërkesat të cilat hyjnë në kompetencat dhe përgjegjësitë e drejtëpërdrejtë e njësisë së vetqeverisjes vendore.

- **Investime që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe blloqet e brendshme të banimit në qytet ose njësi administrative.**
 - Rajonin nr. 1: Rrugët mbi spitalin (asfaltim); Rruga “Bilbil Ceno”; Lagjja “Hajro Çakëri”, rruga “Herbert”, rruga “Xhemil Bej Vlora”; hapja e rrugës në Lagjen “Karabash”; investime në zonën e “Fabrikës së Çimentos, bashkimi i Lagjjes “Partizani” me rrugën “Bilbil Ceno” nëpërmjet një ure lidhëse, rruga “Sofi Arapi”;
 - Rajoni 4: Përmirësimi i infrastrukturës rrugore.
 - Rajoni 3: Përmirësimi i rrugës së “Varroshit” që lidhet me Shkollën “Musa Çakëri”; investim infrastrukturor në bllokun e banimit në Lagjja “28 Nëntori”, pranë Shtëpisë së Oficerëve; zgjerimi i rrugës që ndodhet në bllokun e banimit mbas bankës “Raiffesen”; sinjalistika, parkimet, ndriçimi në rrugët midis Rrugës “Gjergj Arianiti” dhe Rrugës Kosova; rruga “Çajupi” nuk ka dalje në rrugën transballkanike;
 - Rajoni 2: Rruga Hanover; rikonstruksione në rrugën Mira mare, rruga mbi shikun, Ndriçimi i mjedisit mbas shkollës “Ismail Qemali”; rikonstruksioni i rrugës pranë Shkollës Tregtare; Restaurimi i Lagjjes “Avni Rustemi”
 - Rajoni 5: Rikonstruksioni në lagjen “Kushtrimi”; rruga “Demokracia”, rregullimi i rrugëve të brendshme në lagjen Vrenezi, lagjja “28 Nëntorit” (zona e elektrikut); rruga Kanina; lagjja “Hysni Muka”; ndriçimi i rrugës deri në Pusmezin;
 - Njësia Administrative Orikum: Rikonstruksioni i rrugës “Zonja Cure”si dhe rrugës “Neim Dano”; ndriçimi i rrugës së Bulevardit të Tragjasit; ndriçimi në segmente të ndryshme të Orikumit, si dhe të zgjetet segmenti asfaltues në Rradhimë deri tek rruga

e varrezave; rrugët në brendësi të fshatit Dukat; Ndërtimi i një muri mbajtës që ka për qëllim të mos lejojë shkitjen e kodrës së Orikumit

- **Njësia Administrative Qendër:** Ndërtimi i një rruge mbikalimi ose nënkalimi në fshatin Kaninë për të lidhur dy pjesët e fshatit për shkak të By Passit; riasfaltimi i rrugës së fshatit Kërkovë, si rrugët e brendshme të qytetit; rrugët e brendshme dhe ndriçimi në fshatin Panaja, Sherisht; ndriçimi i rrugës që të çon për tek varrezat e fshatit Babicë e Vogël, rikonstruksioni i rrugëve të brendshme të fshatrave Nartë; Oshëtimë etj.
- **Njësia Administrative Novoselë:** Ndriçimi i rrugës që shkon për tek varrezat e fshatit Cerkovinë, disa rrugë të brendshme në fshatin Mifol si dhe në fshatin Novoselë.
- **Njësia Administrative Shushicë:** ndriçimi dhe përmirësimi i infrastrukturës rrugore që të çon për tek varrezat e fshatit Risili, rikonstruksioni i rrugës së fshatit të Bunavisë, Grabanit si dhe sistemi i trotuarëve në fshatin Shushicë; rrugët e brendshme në fshatin Mekat si dhe rruga e Kishës së fshatit.

- **Furnizimi me Ujë të Pijshëm**

Përmirësimi i furnizimit me ujë të pijshëm mbetet një prej prioriteve të parashtruara nga një pjesë e konsiderueshme e qytetarëve në thuajse të gjitha konsultimet publike të realizuara. Më specifikisht: blloku i banimit në Lagjjen “Partizani” që lidhet me zonën e “Llonxhës”; në disa zona të veçanta të lagjes “24 Maji”; rrjeti i brendshëm i ujës-jellësit si dhe ndërtimi i një depoje të ujit në fshatin Bestrovë; përmirësimi i sistemit të ujit të pijshëm në fshatin Llakatund. Gjatë takimit të realizuar në Rajonin nr. 5 një prej problemeve më shqetësuese për një pjesë të konsiderueshëm të qytetarëve ishte pikërisht furnizimi me ujë të pijshëm.

- **Kanalizimi i Ujërave të Zeza/ kanalet kulluese dhe vaditëse**

Në takimet e realizuara në njësitë administrative për një pjesë të banorëve mbetet shqetësim sistemi i kanaleve kulluese dhe vaditëse kjo edhe për vetë faktin që bujqësia është një prej pilareve ekonomik të zonave respektive si pastrimi i kanaleve kulluese në fshatin Novoselë, kanalet vaditëse në fshatin Mifol, sistemi kullues dhe vaditës në fshatin Pish-Poro. Ndërkohë që përse i përket kanaleve të ujërave të zeza qytetarët kërkonin jo vetëm ndërtimin dhe përmirësimin e sistemit si në Rrugën “Dhimitër Konomi”, Lagjjen “Hajro Çakëri”, por edhe pastrimin prej ndotjeve ku shpesh herë ishin edhe inerte.

- **Pastrimi dhe Gjelbërimi**

Për një pjesë të konsiderueshme të qytetarëve përmirësimi i cilësisë së pastrimit të qytetit mbetet prioritet. Veçanërisht gjatë sezonit turistik ku shumëfishohet numri i vizitorëve në qytet qytetarët dhe bizneset kërkonin që të shpeshtohej shërbimi i pastrimit në qytet. Një tjetër shqetësim i qytetarëve ishte shpeshtimi i njësive të grumbullimit të mbeturinave (koshave) si dhe ripëshpërndarje e tyre. Më specifikisht: pastrimi i pyllit të sodës veçanërisht nga mbetetjet e fasonerive dhe bizneseve; pastrimi tek Ura e Zogës (takimet e qytetarëve në rajonin 4), pastrimin i kanaleve të ndryshme në qytet (Fabrika e Çimentos, në lagjen 24 “Maji”, Rajoni

5), pastrimi i kolektorëve në njësitë administrative. Pastrimi i zonës së Ish Kinemasë “Ali Demi” në Rajonin nr.1. Krasitja e pemëve të ndryshme në disa akse të rrugëve të qytetit.

- **Transport Publik**

Gjatë dëgjesave publike qytetarët kanë parashtruar kërkesën për përmirësimin e shërbimit të transportit publik, duke u ndalur veçanërisht në publikimin e orareve në stacionet e autobuzëve dhe zbatimin me përpikmëri prej tyre. Disa prej banorëve të Rajonit 3 dhe 4 kërkuan vendosjen e një itinerari të ri përgjatë rrugës “Transballkanike”, si dhe rivlerësimin e ndalesave të stacioneve të autobuzit. Njëkohësisht banorët e rajonit nr. 1 kërkojnë njëkohësisht që të gjendet një zgjidhje për vendqëndrimin e mjeteve të transportit publik që lidhin qytetin me njësitë administrative.

- **Të tjera**

Në vijim paraqiten disa prej çështjeve të trajtuara dhe shqetësimeve të ngritura prej qytetarëve:

- Gjetja e një zgjidhje për bolierët të cilët qëndrojnë veçanërisht tek pallatet e vjetër të cilët janë shndërruar në burim lagështie dhe rrezik shëmbje për soletat e ndërtesave.
- Krijimi i tregut të shitjes me pakicë të fruta\perimeve në lagjen “24 Maji” konform standarteve përkatëse, njëkohësisht banorët e Rajonit nr. 3 kërkojnë rivlerësimin e mundësi për risistemin e tregut të fruta perimeve në zonë.
- Vendosja e tabelave orinetuese dhe emërtesave në rrugët e brendshme të lagjeve;
- Banorët që i përkisnin grupmoshës së tretë kërkonin që të planifikohen mjedise argëtuese si lulishte në hapsira të ndryshme të qytetit.
- Të gjenden instrumenta të cilat të ndikojnë në përzgjedhjen dhe vendosjen e administratorëve në pallate veçanërisht në pallatet e vjetër.
- Rregullimi i orareve të automjeteve të cilat shërbejnë për furnizimin e njësisve të ndryshme të shërbimit në qytetin e Vlorës.
- Të vlerësohet mundësia për të gjetur në zgjidhje alternative për linjat e internetit apo kompanive të ndryshme televizive të cilat kalojnë në kolona duke krijuar një rrjetë të ndërlikuash fijesh e cila nuk është as estetike dhe as e sigurt për jetën e qytetarëve, kompanitë ti sigurojnë ato nëntokë.
- Kthimi në identitet i Sahatit të Qytetit;
- Gjetja e një zgjidhje për lavazhot e ndryshme në qytet duke parashtruar një sërë problematika nisur prej zhurmës dhe ndotjes që shkaktojnë në mjedis.
- Hartimi i një projekti i cili të ketë për qëllim zgjidhjen e problemit të parkimit duke ndërtuar parkime nëntokësore në tre nyje kyçe të qytetit Rrapi, Tyneli, Kalaja.
- Zhvendosja e varrezave të Fshatit Babicë tek varrezat e qytetit dhe rikonceptimi i kësaj hapsire si një mjedis argëtues, sportive etj....
- Rikonstruksioni i ndërtesave që janë duke u shëmbur dhe fasadave të pallateve të vjetër.
- Krijimi i serviturit të kalimit që lidhë dy pjesët e fshatit Kaninë e cila është ndarë për shkak të kalimit të By Passit;
- Krijimi i servitureve të kalimit midis lagjeve të ndryshme të qytetit.

- Vendosija e sinjalistikës rrugore në seksione të ndryshme të qytetit, veçanërisht në rrugë të cilat ka më shumë probabilitet që automjetet të tejkalojnë shpejtësinë e lejuar.

Nga sa më sipër prej qytetarëve prioritet mbetet përmirësimi i infrastrukturës rrugore, infrastrukturës së institucioneve arsimore, sistemit të ujit të pijshëm dhe kanalizimeve, ndriçimi, shërbimi i pastrimit etj. Janë pikërisht këto prioritet të cilat janë parashikuar në buxhetin e vitit 2025 të cilin e paraqesim për miratim në këshillin e bashkisë. Veçanërisht rëndësi në këtë buxhet i është kushtuar rehabilitimit, sistemit dhe asfaltimit të rrugëve në blloqe sipas rajoneve për të cilat gjatë dëgjësive publike janë paraqitur kërkesa dhe vlera e tyre mund të përballohet nga ky buxhet pasi kostot e rehabilitimit sipas zonave nuk janë shumë të larta.

Ky dokument është hartuar prej grupit të punës të ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Nr. 341, datë 04.10.2023 “ Për Ngritjen e Grupit të Punës Për Hartimin e Buxhetit të Vitit 2025 dhe Ndryshimeve të Mundshme në Paktën Fiskale” , i ndryshuar. Projekt Buxheti përmban të gjithë elementët e përcaktuar në ligjin 139/2015. Më specifikisht në nenin 41 “Buxheti Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe program buxhetor afatmesëm”, kërkohet që:

- Njësitë e vetëqeverisjes vendore hartojnë dhe miratojnë buxhetin vjetor e programin buxhetor afatmesëm, sipas legjislacionit në fuqi që rregullon sistemin buxhetor dhe financat vendore.
- Për qëllime të transparencës e të respektimit të ligjit, buxheti i njësive të vetëqeverisjes vendore duhet të përmbajë:
 - Parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimet e propozuara në secilën kategori shpenzimesh përfshirë edhe shlyerjen e borxhit të njësisë.
 - Të gjitha transfertat të parashikuara për tu marrë nga qeveria qendrore dhe të cilat hyjnë në buxhetin e njësisë dhe që përdoren vetëm për qëllimin për të cilin janë dhënë, në përputhje me rregullat e caktuara nga qeverisja qendrore për përdorimin e tyre.
 - Të gjitha fondet e mbartura nga viti i mëparshëm dhe fondet e parashikuara për tu siguruar në mënyrë të drejtpërdrejtë prej vetë Bashkisë nga çfarëdo burimi, përfshirë këtu të gjitha taksat, grantet nga qeverisja qendrore, tarifrat, vlerësimet, gjobat, grantet nga burime të niveleve të tjera të qeverisjes.
 - Parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për dy vitet buxhetore pasardhëse, parashikimin e shpenzimeve për investimet e reja me informacionin e mëposhtëm:
 - a) Qëllimin e investimit
 - b) planin e financimit, përfshirë mënyrat dhe burimet e financimit
 - c) shpenzimet vjetore që duhen për shlyerjen e kredisë, nëse përdoret, si dhe një preventiv të shpenzimeve operative që lindin si pasojë e kryerjes së investimit.
 - Objektivat kryesorë të buxhetit për vitin pasardhës dhe rezultatet e pritshme, përfshirë treguesit e performancës dhe informacione të tjera shtesë që kërkohen ose mund të kërkohen nga ligji.

Në zbatim të përmbushjes së detyrimeve ligjore për ofrimin e shërbimeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj si dhe prioritetëve të komunitetit është hartuar buxheti i Bashkisë Vlore për vitin 2025 në vlerën **3,679,094 mije lekë** nga të cilat 2,308,523 mije lekë nga të ardhurat e veta

ose 61.24%, 877,759 mije lekë Transferta e Pakushtëzuar ose 23.14%; 582,812 mije leke Transferten Specifike ose 15.62%.

Buxheti sipas programeve buxhetore paraqitet si më poshtë:

| Kapitulli | Emërtimi i Programit Buxhetor | Vlera ne | % ndaj buxhetit |
|-----------|---|------------------|-----------------|
| | | 000 leke | |
| 1 | Shërbime të përgjithshme Administrative dhe investime | 1.005.888 | 26.69 |
| 2 | Shërbime të mbrojtjes ndaj zjarrit | 87,567 | 2.32 |
| 3 | Pyjet dhe kullotat | 17.494 | 0.46 |
| 4 | Uitja dhe Kullimi | 46.679 | 1.24 |
| 5 | Shërbime publike | 198.555 | 5.27 |
| 6 | Pastrimi | 329.996 | 8.76 |
| 7 | Rrjeti rrugor | 362.479 | 9.62 |
| 8 | Gjelberimi | 138.205 | 3.67 |
| 9 | Dekori dhe mirmbajtja e Varrezave | 58.013 | 1.54 |
| 10 | Menaxhimi i mbetjeve | 136,334 | 3.62 |
| 11 | Ndriçimi i rrugëve | 128.039 | 3.4 |
| 12 | Shërbimet kulturore dhe sportive | 187.839 | 4.98 |
| 13 | Arsimi | 877.498 | 23.26 |
| 14 | Kujdesi Social për të sëmure dhe PAK | 30.506 | 0.81 |
| 10 | Familje dhe fëmijët | 68.414 | 1.82 |
| | Fondi Rezerve+fondi i mbrojtjes civile | 95.588 | 2.54 |
| | Totali | 3,769.094 | 100 |

Ndërsa sipas klasifikimit ekonomik të llogarive buxhetore dhe përqindjes që secili zë shpenzimesh zë në totalin e shpenzimeve buxhetore për të ardhurat e veta për vitin 2025, treguesit jepen në tabelën dhe grafikun e mëposhtëm:

Tabela 2

| Programi | Paga +Sig Shoq | Shpenz. Operative | Rezerve+ Emergjencia | investime | Te tjera | Totali |
|----------|----------------|-------------------|----------------------|-----------|----------|-----------|
| Totali | 1,803,171 | 941,438 | 95,588 | 831,923 | 96,974 | 3,769,094 |

- **Objektivat e buxhetit të vitit 2025.**

Objektivat e buxhetit të vitit 2025 janë të pandara me objektivat e buxhetit afatmesëm 2025-2027; ku prioritet e zhvillimit bazohen në Planin e Përgjithshëm Vendor 2017-2030, si dokumenti bazë i cili është përgatitur me ndihmën e ekspertëve ndërkombëtarë, dhe është një mjet kyç i planifikimit të përdorur dhe do të formojnë të ardhmen e qytetit. Dokumenti ka identifikuar një seri prioritesh kyçe ekonomike për bashkinë gjatë kësaj periudhe. Fokusi i Planit të Zhvillimit të Vlorës mund të përmblihet në fushat e mëposhtme:

- Vazhdimi i përmirësimit të konkurueshmërisë dhe cilësisë së produktit turistik;
- Vazhdimi i zhvillimit të zinxhirëve territorialë të bashkëpunimit për një ekonomi të qëndrueshme
- Vazhdimi i nxitjes së sipërmarrjes dhe përmirësimi i kapitalit njerëzor
- Vazhdimi i përmirësimit të cilësisë së jetës dhe shërbimeve për popullsinë rezidenciale dhe rritja e kohezionit social
- Përmirësimi i pastrimit të mjedisit në kuadrin e iniciativës së Qeverisë Shqipëtare për një Shqipëri të Pastër.

Si përfundim referuar kërkesave të përcjella prej strukturave përgjegjëse për ushtrimin e funksioneve të bashkisë, prioriteteve të përcaktuara prej qytetarëve gjatë dëgjësive publike, dokumentave dhe prioriteteve afatgjatë dhe afatmesme të institucionit, objektivat e buxhetit për vitin 2025 janë si më poshtë vijon:

- Përmirësimi i Infrastrukturës urbane dhe rurale nëpërmjet projekteve zhvillimore në elementë të ndryshëm si rrugë, ndiçim, kanalizimet etj.
- Rikualifikimi i hapësirave publike, rehabilitim i sipërfaqeve të gjelbërta ekzistuese, shtimi i ambjenteve shplohëse dhe argëtuese.
- Përmirësimi i cilësisë së infrastrukturës arsimore si dhe krijimi i infrastrukturave të reja sipas nevojave.
- Përmirësimi i shërbimit të pastrimit në qytet duke rikonceptuar, strukturuar dhe shpeshuar frekuencën e pastrimit të qytetit në zonat urbane dhe rurale.
- Përmirësimi cilësisë së jetës së shtresave në nevojë nëpërmjet programeve të ndryshme sociale;
- Rritja e vizibilitet të qytetit nëpërmjet mbështetjes së projekteve të brendshme dhe ndërkombëtare duke rritur imazhimin e qytetit dhe forcimin si një brend turistik në mesdhe dhe më gjerë.

Buxheti i Bashkisë Vlorë për vitin 2025, përbën dokumentin financiar, I cili balancon të ardhurat dhe shpenzimet sipas programeve në vlerën 3,769,094 mijë lekë.

KAPITULLI II: PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE NË BUXHETIN E BASHKISË VLORE PËR VITIN 2025

Sipas nenit 34 te ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, pika 3 dhe 4, njësitë e vetëqeverisjes vendore financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga qeverisja qendrore dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt atyre nga ndarja e taksave dhe tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacione, si dhe burime të tjera, të parashikuara në ligj. Njësive vendore u garantohet me ligj e drejta për krijimin e të ardhurave në mënyrë të pavarur.

Për vitin 2025 të ardhurat e përgjithshme të Bashkisë Vlore, nga të gjitha burimet e financimit parashikohen të jenë **3.769.094 mijë lekë**.

Këto të ardhura, sipas ligjit të mësipërm, vijnë nga dy burime të ardhurash si më poshtë:

1. Nga burimet e Buxhetit të Shtetit ku përfshihen transferta e pakushtezuar dhe transferta specifike per funksionet e bashkise.
2. Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen te ardhurat tatimore (nga taksat vendore), jo tatimore (nga tarifat për shërbimet publike që ofrojnë dhe te ardhurat e tjera vendore).

| NR. | EMERTIMI | Fakt 2022 | Fakt 2023 | I Pritshëm 2024 | Plan 2025 |
|-----|---|------------------|------------------|------------------|------------------|
| 1 | Te ardhurat nga taksat e tarifat te vitit korrent | 1,399,948 | 1,090,867 | 1,607.587 | 2.308.523 |
| 2 | Te ardhurat e trashëguara nga viti i mëparshëm | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 3 | Transferta e pakushtëzuar | 565,117 | 674,396 | 798,527 | 877.759 |
| 4 | Transferta e pakushtëzuar nga viti i mëparshëm | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 5 | Transferta specifike | 429,407 | 447,453 | 485,785 | 582.812 |
| 6 | Transferta specifike nga viti i mëparshëm | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | T O T A L I | 2,394,472 | 2,212,716 | 2,891.899 | 3,769.094 |

Të ardhurat nga burimet e veta vendore përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave të Bashkisë Vlore me parashikim prej **2,308,523 mijë lekë**, dhe zënë 61.24% të totalit të të ardhurave.

Të ardhurat nga burimet qendrore (transferta e pakushtëzuar) prej **877.759 mijë lekë** zënë 23.28% të totalit të të ardhurave

Për vitin 2025 krahas transfertës së pakushtëzuar është akorduar edhe fondi transferta specifike prej **582,812 mijë lekë** ose 15.48 % për funksionet e transferuara.

II.1. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE

Të ardhurat nga taksat e tarifat vendore për vitin 2025 janë programuar në shumën **3.769.094 mijë lekë**.

Bashkia Vlore veprimtarinë fiskale e mbështet në ketë bazë ligjore:

- Ligjin nr.9920 datë 26.05.2008 "Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
- Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar, me ligjin 181/2013 dt. 28/12/2013, botuar në fletoren zyrtare nr.203, dt.30/12/2013 "Për disa ndryshime dhe shtesa me ligjin nr.9632, dt.30/08/2006 "Për sistemin e taksave vendore i ndryshuar".
- V.K.B Nr. 96, datë 07.12.2023 "Për miratimin e sistemit të taksave tarifave vendore në territorin e Bashkisë Vlorë për vitin 2024",

Bashkia Vlorë, garanton funksionin e saj, nëpërmjet taksave të parashikuara në ligj sipas akteve ligjore, ashtu edhe taksat e përkohshme dhe tarifat, të miratuara nga Keshilli i Bashkisë.

1. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme.
2. Taksa e mjeteve të përdorura.
3. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.
4. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme (ndërtesë + toke bujqësore).
5. Taksa e truallit.
6. Taksa e fjetjes në hotel.
7. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndertimet e reja.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksë parkimi.
10. Taksa mbi të ardhurat personale.
11. Tarifa për zënien e hapësirave publike.
12. Tarifa e pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit.
13. Tarifa e shërbimit për subjektet me aktivitet ndërtimi.
14. Tarifa për shërbime të tjera nga pushteti vendor.
15. Tarifa për leje dhe çertifikata transporti.
16. Tarifa e shërbimit të ujitjes.
17. Të ardhura të tjera (nga qiratë, mjete, godine, tokë).
18. Të ardhura nga aplikim gjobash..
19. Të ardhura nga kopshte, çerdhe e shkolla.
20. Të ardhura nga institucionet vartësë.
21. Të ardhurat nga transfertat e pakushtëzuara.

Ky grup taksash dhe tarifash përbëhet nga:

1. Të ardhura tatimore

2. Të ardhura jo tatimore.

Pasqyra përmbledhëse e të ardhurave për vitin 2025

| Nr. | EMERTIMI | Fakti 2022 | Fakti 2023 | Plani 2024 | I pritsh 2024 | Plani 2025 |
|------------|---|------------------|------------------|------------------|------------------|------------------|
| I | Të ardhura nga taksat vendore | 766,957 | | 997,619 | | 1,162,337 |
| 1.1 | Te ardhura nga Agjentet Tatimor | 123,600 | 83,826 | 113,500 | 114,190 | 126,500 |
